

ARSIMI NË PEJË NDËR VITE E SHEKUJ

Reshat Nurboja

PhD kandidatë në Universitetin Eutopian të Tiranës

Abstrakt

Ky punim ka për qëllim të pasqyrojë historinë dhe rrethanat e zhvillimit të arsimit shqip në Pejë gjatë viteve e shekujve nëpër okupimet e ndauarshme të këtij qyteti të lashtë Ilir, që nga okupimi nga: Perandoria Romake, Perandoria Bizantine, Perandoria Osmane, Mbretëria Austro-Hungareze, Mali i Zi, Mbretëria Serbo-Kroate-Slllovene, Fashizmi Italian e Gjerman, Jugosllavia e KAÇKJ-së, RSFJ-së, RFJ dhe Serbia e deri në ditë e sotme të lirisë e pavarësisë.

Punimi synon të publikojë “çmimin” që është dashur të paguaj populli shqiptarë i Pejës për të mbrojtur gjuhen dhe identitetin e vet kombëtar dhe për t’u arsimuar, jo rrallë herë ky çmim ka nënkuptuar vrasjen, burgosjen, rrahjen, debimin, plaçkitjen e çka jo tjetër që është dashur të paguhet për themelimin, mbrojtjen dhe zhvillimin e shkollës shqipe në Pejë.

Punimi pasqyron poashtu një gjendje shqetsuese të arsimit fillor dhe të mesëm në Komunën e Pejës gjatë këtyre 16 viteve të çlirimit dhe 8 viteve të pavarësisë dhe ate jo vetëm në aspektin e cilësisë të arsimit por edhe në paksimin enorm të numrit të nxënësve që vijnë këto dy nivele të arsimit, ku nga 18.225 nxënës në 785 paralele sa egzistonin në vitin shkollor 2003/2004 në Komunën e Pejës në nivelin fillor (klasa e parë deri në të nëntën) në vitin shkollor 2012/2013 në këtë nivel të arsimit janë regjistruar vetëm 14.620 nxënës në 652 paralele. Që dmth për 9 vite Komuna e Pejës në arsimin fillor ka 3.605 nxënës ose 133 paralele më pak në vitin 2012 se sa në vitin 2003, dhe ky trend i pakësimit të nxënësve në nivelin fillor dhe të mesëm në Komunën e Pejës po vazhdon me të njejtin tempo.

Ky punim ka mundësi dhe duhet të nxisë debat në mes të shoqërisë dhe



=====

institucioneve komunale e të atyre qendrore për vlerën dhe rëndsinë që e ka pasur shkolla dhe arsimit për popullin e Pejës gjatë viteve e shekujve, çfarë e ka aktualisht dhe nga është duke shkuar.

Fjalët kyçe: Peja, Shkolla, Okupimet, Flijimet, Të arriturat

Hyrje

Meqenëse, Peja që në kohrat e lashta romake e ka pasur statusin e Municipiumit, që nënkupton që ka qenë vendbanim me rëndësi i kohës, kjo nënkupton se Peja edhe në ato kohra ka pasur edukim apo shkollim me plan programe përkatëse për ato rrethana...Për këtë arsye është vështirë të vërtetohet me saktësi se kur u themeluan shkollat e para dhe sistemi i arsimit në trevat shqiptare në përgjithësi e në Pejë në veçanti, meqenëse struktura e nocioni i arsimit nëpër shekuj ka qenë i ndryshëm si për nga koncepti poashtu edhe për nga përmbajtja. Për këtë arsye në këtë punim do të fokusohem vetëm në shkollat-arsimin në Pejë sipas botëkuptimit bashkohor dhe për të cilat egzistojnë fakte dhe dokumente të qendrueshme shkencore. Duke u bazuar në këtë përcaktim, punimin e filloj me Haxhi Beun, një vendas i pasur i Pejës, i cili ndërtoi Hamamin e qytetit “në vitin 1545 ngriti edhe shkollën e parë në Pejë – mektebin apo edhe medresen⁸⁹ mu pranë hamamit”⁹⁰. “Nga kjo shkollë dalin edhe intelektualët e parë. Njëri prej tyre ishte Ipekli Mehmed efendiu i cili sherbeu në institucionet më të larta të Perandorisë Osmane. Ipekli Mehmed efendiu me 1592/3 (1001 hixhri) e emrua mderris (professor) i Medresës Zejni Çelebi në Stamboll, me rrogë ditore (yevmi) 50 akçe. Pastaj transferohet në medresen e Hajdar pashës (1597/8) në Stamboll, me (1601) në medresen e Mehmed pashës në Yskydar, me 1607/8 caktohet kadi në Izmir. Vdiq me 161091.

Lidhur me arsimin shqip në Kosovë duhet të përmendet një shkollë seminari që nga viti 1664 në Pejë për shqiptarët e besimit katolik. Sipas autorit Gaspër Gjini seminaristët shkonin nëpër shtëpi private-shkolla pranë kishës...⁹²

Akademik Jashar Rexhepagiqi në librin e tij shkencor “Zhvillimi i arsimit dhe i sistemit shkollor të kombësisë shqiptare në territorin e Jugosllavisë së sotme deri në vitin 1918, të botuar në Prishtinë në vitin 1970” potencon se “para vitit 1848 në

⁸⁹ Mekteb: shkollë fillore; Medrese: shkollë e mesme dhe e lartë

⁹⁰ Skender Rizaj. “Kosova gjatë shekujve XV,XVI dhe XVII. Rilindja Prishtinë 1982,fq.236.

⁹¹ Skender Rizaj. “Kosova gjatë shekujve XV,XVI dhe XVII. Rilindja Prishtinë 1982, fq.236, 237. Dhe Cahid Baltaci.XV, XVI.Asirlada Osmanli Medreseleri,Istanbul,1976, fq.350.

⁹² Prof.Dr. Nesim Vala. Kjo është Gjakova.Gjakovë 2015. Fq. 127. dhe Gaspër Gjini. Peshkopata e Shkupit dhe e

Prizrenit gjatë shekujve. Zagreb,1986

=====

dhjetëvëshin e parë të shekullit XIX (që nënkuptohet, vitet 1800 -1810 verejtje e autorit) u hapen shkolla në gjuhën shqipe në disa qytete të Kosovës, si në Prizren, në Pejë por edhe në Gjakovë.⁹³

Në vitin 1869, Haxhi Zeka pasi i kreu studimet në Medresën e Madhe duke u specializuar për drejtësi⁹⁴ filloi të punoi edhe si mësues. Vendi ku Mulla Zeka filloi punën e tij kulturo-arsimore dhe atdhetare ishte shtëpia e tij, ku njërin nga dy dhomat e kësaj shtëpie e shndërroi në mësojtore⁹⁵. Disa nga pleqtë e Pejës mendojnë se kjo shtëpi-shkollë, që edhe sot gjendet në rrugën "Bashkimi i luftetarëve" nr.8, në Karagaç⁹⁶, me ç'rast autobiografi më i shquar i jetës dhe veprimtarisë atdhetare të Haxhi Zekës, zotëri Ismail Haxhitahiri në dorëshkrimin e tij me titull "Shënime të shkurta dhe kujtime për Haxhi Zekën" të gjetur në Teqen e Bektashinjëve të Gjakovës potencoi se "Zejnel efendia, sa punoi mësues, u bë fener ndriçimi në Pejë...⁹⁷

Në vitin 1878 si rezultat i qendrimeve dhe detyrave të dalura nga punimet e Lidhjes së Prizrenit në vitin 1878, Haxhi Zeka e hap një shkollë tjetër shqipe edhe në Pejë krahas asaj në Prizren.

Kjo shkollë shqipe në këtë periudhë kohore u themelua nga Haxhi Zeka, një nga ideatorët, pjesmarrësit dhe personalitet më të shqura të atij takimi në Prizren. Shkollën fillimisht e kishte vendosur në "sarajet e veta – tani kulla e Jashar Pashës" në Pejë, e nga aty pas mbajtjes së Kuvendit gjithshqiptarë të Lidhjes së Pejës "Besa – Besë" në vitin 1899, e me qëllim të legalizimit dhe zgjerimit të shkollës shqipe, Haxhi Zeka e ka transferu në objektin e Shkollës së Vogël afër Hamamit të vjetër të qytetit dhe Hamam Xhamisë (në të cilën edhe është mbajtur mbledhja plenare e Kuvendit të Pejës "Besa – Besë") .

Mësimet në shkollën e parë shqipe me shtatë nxënës i ka mbajtur vet Haxhi Zeka. Pas vrasjes së tij në vitin 1902 kjo shkollë pushoi se ekzistuari...

Në këtë shkollë të Haxhi Zekës, nuk predikohej feja por atdhetarizmi dhe "shkrim e kendimi" siq emertohej në atë kohë që nënkuptonte mësimin si me shkru dhe me lexu në gjuhën shqipe dhe me alfabetin shqip.

Programi i kësaj shkolle bazohej në programin e patriotëve shqiptarë të vitit 1868 të cilët ishin tubuar mu në qendër të Perandorisë, në Stamboll, dhe vendosën:

⁹³ Prof.Dr. Nesim Vala. *Kjo është Gjakova.Gjakovë 2015. Fq. 128. Dhe Akademik Jashar Rexhepagiqi "Zhvillimi i*

arsimit dhe i sistemit shkollor të kombësisë shqiptare në territorin e Jugosllavisë së sotme deri në vitin 1918, të

botuar në Prishtinë në vitin 1970" Fq.152-165.

⁹⁴ Prof.dr. Shefqet Canhasi.Haxhi Zekë Byberi.Besa, Prishtinë 2004,fq.44

⁹⁵ Vepra e cituar.Fq.70

⁹⁶ Vepra e cituar.Fq.82

⁹⁷ . Prof.dr. Shefqet Canhasi.Haxhi Zekë Byberi.Besa, Prishtinë 2004,fq.70

=====

“Duhet ta shkruajmë gjuhën shqipe, duhet të zgjedhim ato germa që përcjellin tingullin më lehtë, tingullin e bukur të gjuhës sonë. Dhe, gerrat të jenë shqip!”. Për këtë arsye Sami Frashëri shkruan: “S’mund të ketë Shqipëri pa shqiptarë, s’mund të ketë shqiptarë pa gjuhë shqip, s’mund të ketë gjuhë shqipe pa shkolla në të cilat të mësohet shqipja”.

Në “klasë” ishte i vendosur në shqip dhe arabisht hadithi i Profetit Muhamed “HYBUL VATAN MIN EL MAN” (“Nuk mund të ketë fe pa mëmëdhe”)98.

Këtë fakt e dokumenton edhe studimi i Prof. Dr. Nesim Vala në monografinë “Kjo është Gjakova” të botuar në vitin 2015, ku theksohet se “Me insistimin e Austrisë, Porta (perandoria Osmane, verejtje e autorit) u detyrua të lejonte hapjen e shkollave dhe përdorimin e gjuhës shqipe si gjuhë mësimi...Shkolla shqipe pas Lidhjes Shqiptare të Prizrenit u themeluan në Prizren, në Zym të Hasit, në Gjakovë dhe Pejë”99

Çdo kërkesë, protestë dhe kryengritje e shqiptarëve për hapjen e shkollave shqipe gjatë tërë okupimit nga perandoria Osmane u shtypën në mënyrë të përgjakshme nga pushteti dhe ushtria turke e cila dihet se në Pejë ishte numërikisht disa herë më e fuqishme se kryengritësit shqiptarë100. Edhe në këto rrethana dhe çmimin e paguar në gjak popullata shqiptare e Pejës ka arritur në periudha të caktuara të hapin shkolla ku gjuha shqipe ishte gjuhë mësimi. Një rrugëtim të tillë apo të ngjajshme pejonitë e kanë pasur edhe gjatë okupimit të rradhës nga Serbia pas Luftës së Dytë Botërore.

Poashtu, edhe në periudhën, para okupimit të parë të Pejës nga Mali i Zi në vitin 1912 ose nga ana e Serbisë në vitin 1918, Peja gjatë viteve 1915 – 1918 ishte nën administrimin Austro Hungarez e cila kishte lejuar dhe ndihmuar hapjen e shkollave shqipe në Pejë.

Gjatë kohës së Austro-Hungarisë në Pejë ishin hapur 4 shkolla shqipe me 800 nxënës101, të cilat me pushtimin e Pejës nga Serbia në vitin 1918 ishin ndaluar dhe mbyllur. Ekzistimin e shkollave shqipe në Pejë para pushtimit të saj nga Serbia e deshmojnë edhe vet serbët siq është rasti me Pavle Joviqeviq dhe Mita Milkoviq të cilët në librin e tyre “Lufta e komunistëve të Pejës në mes dy luftërave 1918-1941” të cilët shkruajnë : “Meqë ishin ndaluar të gjitha shkollat shqipe të cilat qenë hapur gjatë kohës së pushtimit austro-hungarez (atëherë punonin katër shkolla fillore në Pejë me më shumë se 800 nxënës shqiptarë...autoritetet serbe (verejtje e autorit)

⁹⁸ Nga rrefimet dhe kujtimet e Miki Pashës, nipit të Haxhi Zekës

⁹⁹ Prof. Dr. Nesim Vala. *Kjo është Gjakova*. Gjakovë 2015. Fq. 128. Dhe

¹⁰⁰ Pavle Joviqeviq dhe Mita milkoviq “Lufta e komunistëve të Pejës midis dy luftërave (1918-1941). Botuës:

Këshilli Komunal i, LSHL, LNÇ Pejë. Fq. 154

¹⁰¹ Po aty.

=====

marrin masat përkatëse të pëngojnë hapjen e tyre, duke shfrytëzuar sidomos rrethanën se pakica shqiptare është gjetur “jashtë sistemit të mbrojtjes ndërkombëtare” në pikëpamje të së drejtës për shkollim në gjuhën amtare¹⁰²

Pas okupimit të Pejës nga Mali i Zi në vitin 1912, për nevoja të kolonistëve malazez dhe serb, në Pejë me dekretin e datës 07 shtator 1913, të mbretit të Malit të Zi, Nikolla Petroviq u hap Gjimnazi i lartë shtetror 8 klasësh, nivel i rrallë i shkollimit për atë kohë jo vetëm në Kosovë, Mal të Zi dhe Serbi. Një gjimnaz të tillë ishte vetëm në kryeqytetin e atëhershëm të Malit të Zi, në Cetinje. Në vitin e parë shkollor (1913) në këtë gjimnaz ishin regjistruar 48 nxënës, mendohet se të gjithë ishin të nacionalitetit malazez, se po që se edhe ka ekzistuar ndonjë shqiptarë, kjo nuk ka mundur të dokumentohet, “meqenëse sikurse në të gjitha rastet tjera, edhe në shkolla, ish autoritetet e mbretisë SKS i kanë “ripagëzuar” mbiemrat shqiptarë duke u shtuar në fund të mbiemrave prapashtesën “viq” apo “iq”. Në të gjitha dokumentet e para Luftës së Dytë Botërore, sikurse nga ana e qeverisë poashtu edhe në ato të cilat i kanë shkruar komunistët dhe njerëzit e tjerë përparimtarë emrat shqiptarë kanë qenë “ripagëzuar” gjithashtu¹⁰³.

Ndërsa okupatori i radhës në Pejë, Serbia me dekretin e mbretit të tyre Aleksandar Karagjorgjeviq “SN nr.30751”, me 24 gusht 1929, Gjimnazin e Pejës nga gjimnazi 8 klasësh e reduktoi në gjimnaz katërklasësh.

Ndërtesa aktuale e Gjimnazit të Pejës u ndërtua në vitin 1934. Në këtë vit gjimnazi i Pejës përseri u shnëdërua nga gjimnazi vetadministrues në gjimnazë të plotë të të klasësh. Ndërtesa e re, moderne e gjimnazit të Pejës në fund të atij viti “shugurohet” nga klerikët e tre feve...¹⁰⁴

Pas Luftës së Dytë Botërore, Gjimnazi i Pejës ishte një nga dy shkollat e mesme (së bashku me Gjimnazin e pestë në Beograd) më cilësore në ish Jugosllavi ku ishin 6 republika (Slloveni, Kroaci, Bosnje dhe Hercegovinë, Serbi, Maqedoni dhe Mal të Zi), 2 krahina autonome (Kosova dhe Vojvodina) dhe 21 milionë banorë. Nga ky gjimnaz kanë dalë edhe pjesa dërmuese e elitës më të lartë intelektuale dhe profesionale jo vetëm të Pejës e Kosovës por pa modesti edhe të asaj gjithshqiptare.

Mësimdhënësi i gjimnazit të Pejës Savo Vukmanoviq, në periudhën e okupimit të Pejës nga mbretëria Serbo – Kroate – Sllovene, parashtron çështjen: “ se është për të ardhur keq që midis nxënësve të gjimnazit vetëadministrues nuk ka një numër më të madh të nxënësve shqiptarë, të cilët për nga sjellja, zelli dhe dija

¹⁰² Dr. Branko Petranoviq “Istorija Jugoslavije 1918-1978” fq.91.

¹⁰³ Pavle Joviqeviq dhe Mita milkoviq “Lufta e komunistëve të Pejës midis dy luftërave (1918-1941). Botuës:

Këshilli Komunal i, LSHL, LNÇ Pejë, fq.8.

¹⁰⁴ “Gazeta” Zetski glasnik” nr.101 i vitit 1934.

=====

gjithmonë janë të parët”¹⁰⁵

Me 6 janar të vitit 1929, mbreti serb Aleksandër Karagjorgjeviqi me 6 janar 1929, heqë “liritë” kushtetuese dhe vendos regjimin diktatorial në Mbretinë Serbo – Kroate dhe Sllovene. Duke u bazuar në këtë dekret, Shtabi i Përgjithshëm Jugosllav merr qendrimin se dërgimi i fëmijëve në “shkolla të huaja”, mendohet në Shqipëri, duhet të ndalohej.¹⁰⁶

Qeveria e gjeneralit Petar Zhivkoviç, të cilin e emron mbreti, shpall me 4 korrik 1930 deklaratën programatike e cila e thekson edhe më tepër karakterin serbomadhe dhe diktatorial të pushtetit të ri dhe qëllimin që të çkombëtarizojë kombet dhe kombësitë joserbe.¹⁰⁷

Peja, në vitin 1919, kishte edhe Shkollën e zanatit dhe tregtare për meshkuj dhe Shkollën e zanatit për femra. Në vitin shkollor 1920/21 në Shkollën e zanatit dhe tregtare në Pejë regjistrohen 49 nxënës, prej tyre vetëm 6 shqiptarë (dy katolikë dhe 4 musliman).¹⁰⁸

Duke dashur të përparojë bujqësinë, Këshilli i Banit me 18 dhjetor 1930 mirret vendimin për hapjen e shkollës së ulët bujqësore në Pejë me detyrë që të përgatitë të rinjtë-kolonistë që të punojnë më mire token dhe të selitin kultura të reja bujqësore...Mirëpo kjo shkollë fillon të funksionoi tek në vitin 1934, kur Administrata e banit jep një kredi prej 200.000 dinarëve për ngritjen e shkollës dhe të fermës eksperimentale. Dhe kështu krijohet edhe “Fidanishtja e Banit” dhe shkolla fillimisht meqenëse nuk ekzistonin mësimdhënës të kualifikuar në fillim kufizohej vetëm në mbajtjen e kurseve praktike bujqësore. Mbas Ministria e Bujqësisë i miraton edhe një ndihmë shtesë prej 350.000 dinarëve Administratës së Banit, shkolla e ulët bujqësore fillon të punojë zyrtarisht po atë vit d.m.th. në vitin 1934.¹⁰⁹

Pos gjimnazit, Peja kishte edhe një shkollë të tillë mbresëlënëse, e ajo ishte Shkolla e Mesme e Arteve, e cila ishte vatër e pothuaj i të gjithë piktorëve më kulminant shqiptarë dhe jo vetëm të tyre në Kosovë dhe të tjerë anëkënd ish Jugosllavisë.

Nga kjo shkollë e artit kanë dale piktorë, skulptorë dhe grafistë të shquar që sot me ta mburret arti pamor i Kosovës dhe ai gjithkombëtar.

¹⁰⁵ Gazeta “Slobodna misao” nr.1 të vitit 1934.

¹⁰⁶ Pavle Joviqeviç dhe Mita milkoviç “Lufta e komunistëve të Pejës midis dy luftërave (1918-1941). Botuës:

Këshilli Komunal i, LSHL, LNÇ Pejë, fq.216.

¹⁰⁷ Vepra e cituar. Fq.211.

¹⁰⁸ Pavle Joviqeviç dhe Mita milkoviç “Lufta e komunistëve të Pejës midis dy luftërave (1918-1941). Botuës: Këshilli Komunal i, LSHL, LNÇ Pejë, fq.155.

¹⁰⁹ Gazeta “Zetski glasnik”, nr. 35 I vitit 1934

Shkolla – arsimi në Pejë në shekullin 21

Arsimi fillor dhe i mesëm i ulët

Arsimi fillor dhe i mesëm i ulët në Kosovë është arsimi i detyrueshëm, dhe kjo do të thotë se të gjithë fëmijët dhe të rinjtë në Kosovë duhet të kenë mundësi të barabartë për shkollim. Ky arsim zhvillohet sipas modelit 5 + 4 vite dhe është i aplikuar që nga viti shkollor 2004/05. Niveli i parë, përfshinë: Arsimin fillor, fazën e parë të nivelit të arsimit bazë e cila zgjat 5 vite, ku përfshihen fëmijët e moshave 6 deri në 12 vjeç, dhe niveli i dytë: arsimi i mesëm i ulët, faza e dytë e arsimit bazë e cila zgjat 4 vite dhe përfshinë fëmijët e moshave 12 deri në 15 vjeç. Para kësaj reforme ky cikël i shkollimit është njohur apo emertuar si shkollë fillore dhe ka zgjatë 8 vite.

Me qëllim të pasqyrim të një problemi shumë shqetësues dhe kërcnuës më shumë se gjithçka tjetër për Pejë dhe jo vetëm Pejë në këtë studim do t'i prezentoj statistikën e vijshmërisë së mësimin në Pejë në vitin shkollor 2003 – 2004 dhe të vitit shkollor 2012 – 2013 dhe në bazë të rezultateve të arritura nga një analizë kritike shkencore vetvetiu konfirmohen të dhënat që duhet të alarmojnë jo vetëm institucionet kometente dhe përgjegjëse komunale dhe shtetërore por edhe mbarë shoqërinë pejë dhe atë kosovare.

Në vitin shkollor 2003-2004 Komuna e Pejës në sistemin fillor të arsimit ka pasur 47 shkolla me 738 paralele me gjithsejtë 18.225 nxënës, prej tyre 8.755 ishin të gjinisë femrore e 9.470 të gjinisë mashkullore. Prej tyre 10.050 nxënës kanë qenë në nivelin e arsimit fillor, faza e parë që nënkupton nxënësit prej klasës së parë deri në të pestën dhe 8.122 nxënës të klasave të mesme të ulët që nënkupton klasën e gjashtë deri në atë të nëntën dhe 53 nxënës në arsimin fillor të kombinuar (klasa e parë deri në klasën e)110. Gjithsejtë arsimtarë në këtë nivel të arsimit në këtë vit shkollor kanë qenë 956, prej tyre 499 të gjinisë femrore dhe 457 të gjinisë mashkullore111.

Në nivelin e tretë të arsimit apo në arsimin e mesëm të lartë, të njohur më shumë si “shkolla e mesme” në vitin shkollor 2003-2004, në Komunën e Pejës kanë ekzistuar 7 shkolla të mesme me 181 paralele (me ato serbe në Gorazhdec) prej tyre në 13 paralele mësimi është vijuar në gjuhën serbe (apo boshnjake)

Në këto shkolla të mesme mësimin e kanë vijuar 4.168 nxënës me 320 arsimtarë e profesor me numrin mesatar të nxënësve në paralele 13112, prej numrit të përgjithshëm të arsimtarëve-profesorëve 102 ishin të gjinisë femrore e 218 të

¹¹⁰ Qeveria e Kosovës- Ministria e Shërbimeve Publike. Seria-5 statistikë Sociale. Statistikat e Arsimit në Kosovë 2003 – 2004. Tabela 9, fq. 16

¹¹¹ Vepra e cituar. Tabela 7, fq. 14

¹¹² Vepra e cituar. Tabela 16. Fq. 25

gjinisë mashkullore. 24 prej tyre kanë dhënë mësim në gjuhen serbe¹¹³.

Ndërsa, në vitin shkollor 2012/13 nga 48 shkolla me 652 paralele. Arsimi fillor (klasa e parë deri në të pestën kishte 326 paralele ndërsa ai i mesëm i ulët (klasa e gjashtë deri në atë të nëntën) i ka pasur 291 paralele dhe 33 paralele fillore kanë qenë të kombinuara që nënkupton në një paralele ka pasur nxënës prej klasës së parë deri në atë pestën dhe 2 paralele kanë qenë me nxënësit të nivelit të mesëm të ulët, prej klasës së gjashtë deri në të nëntën. Në këtë vit shkollor mësimin e kanë vijuar 14.620 nxënës në 652 paralele prej tyre 6.967 kanë qenë të gjinisë femrore dhe 7.653 të gjinisë mashkullore. Në vitin shkollor 2012-2013 kanë qenë të punësuar 893 mësimdhënës. Prej tyre 547 të gjinisë femrore dhe 346 të gjinisë mashkullore¹¹⁴.

Arsimi i mesëm i lartë dhe superior

Në arsimin e mesëm të lartë gjegjësisht në 8 shkolla të mesme në Pejë me 252 paralele ku sigurisht janë përfshirë edhe dy shkollat private ka pasur 6.372¹¹⁵ nxënës prej tyre 2.888 të gjinisë femrore dhe 3.484 të gjinisë mashkullore për të cilët kanë qenë të angazhuar 457 mësimdhënës prej të cilëve 196 ishin të gjinisë femrore dhe 261 të gjinisë mashkullore.

Nga këto të dhëna, e vertetojmë shqetësimin e pasqyruar në fillim të kësaj analize. Konkretisht: Në Komunën e Pejës në vitin shkollor 2003-2004, në nivelin fillor (klasa e parë deri në të nëntën) mësimin e kanë vijuar 18.225 nxënës në 785 paralele, ndërsa në vitin shkollor 2012-2013 vetëm 14.620 nxënës në 652 paralele. Për 9 vite në Komunën e Pejës në arsimin fillor ka 3.605 nxënës ose 133 paralele më pak në vitin 2012 se sa në vitin 2003.

Nga ky elaborim shifet se nga klasa e parë deri në atë të nëntën numri i nxënësve në mënyrë drastike bie e arsyet pse ndodhë kjo do të përpiqëm të gjejë shkakun, a është shpërngulja massive e familjeve nga Peja, rënja e natalitetit apo ku qendron arsyeja e pakësimit aq të theksuar të klasave me nxënës?

Vetëm nga një veshtrim i parë pa hyrë në një analizë të thellë të këtyre të dhënave lehtë mund të konstatohet se zvoglimi drastik i nxënësve posaqerisht i referohet nxënësve të klasave të ulëta e më pak të atyre të larta që nënkupton se ata i takojnë familjeve më të reja në moshë e kjo nënkupton se shkas i zvogëlimit të

¹¹³ Meqenëse këto të dhëna janë nga Institucionet e përkohshme të menagjuara nga UNMIKU-u, nga ata nuk është bërë dallimi në mes gjuhës serbe dhe asaj boshnjake dhe i kanë evidentuar të dy këto gjuhë si gjuhë serbe!

¹¹⁴ Qeveria e Kosovës-Zyra e Kryeministrit: Agjencia e Statistikave të Kosovës. Seria e 5. Statistikat e arsimit 2012-2013. Tabela 36. Fq.49

¹¹⁵ Qeveria e Kosovës-Zyra e Kryeministrit: Agjencia e Statistikave të Kosovës. Seria e 5. Statistikat e arsimit 2012-2013. Tabela 70.fq.77

=====

numrit të nxënësve në këtë nivel të shkollimit është shpërngulja e prindërve të tyre në vende perendimore!

Pakësimi i nxënësve në sistemin tone arsimor në Komunën e Pejës vazhdon me një trend të njejtë edhe në vitet në vazhdim e këtë e argumentojmë edhe më këto statistika.

Në vitin shkollor 2015 – 2016 arsimi fillor në Komunën e Pejës, prej klasës së parë deri në atë të nëntën ka regjistruar 13.639116 nxënës në shkollat publike dhe 69 nxënës në dy shkollat private. Nga kjo rezulton se në Komunën e Pejës ka 981 nxënës më pak se në vitin shkollor 2012-2013. Në këtë nivel të arsimit janë të punësuar 988 mësimdhënës në shkolla publike dhe 62 në tre shkollat private, gjithsejt 1050 mësimdhënës në nivelin e arsimit fillor (klasa 1-9). Nga këto rezultate për çudi rrjedh fakti se edhe pse numri i nxënësve është pakësuar për 981 nxënës në nivelin fillor të arsimit dhe nëse këtë numër e pjestojmë me 16 sa ishte mesatarisht numri i nxënësve në një paralele, atëherë rezulton se gjatë kësaj periudhe tre vjeçare (2012/3 – 2015/16) në Komunën e Pejës në nivelin e arsimit fillor ka 61.31 paralele më pakë. Në këtë nivel të arsimit edhe pse është zvogëluar për më shumë se 61 paralele ose 981 nxënës, numri i mësimdhënësve është rritur për 88 mësimdhënës.

Ndërsa, në nivelin e shkollave të mesme, nga 6.372 nxënës sa kanë qenë në vitin shkollor 2012-2013, në vitin 2015-2016 ky numër ka zbritur në 5.203 nxënës apo 1.169 nxënës më pak...!!! Kujdes, Kosova po zbrazet aq shpejt sa po që se nuk ndryshon diqka shumë positive dhe përmbajtësore në këtë drejtim nuk dihet se për kënd janë ndërtuar apo planifikohet të ndërtohen shkollat në Komunën e Pejës, krahas kësaj edhe të gjitha planet tjera zhvillimore.

Sistemi i arsimit në Pejë, si në të gjithë Kosovën ka probleme të shumta serioze si në nivelin e cilësisë dhe të edukimit poashtu edhe në të gjitha sferat e fushëveprimtarisë së saj. Me këtë nivel të arsimit nuk mund të arrihet e as të synohet një e ardhëme çfarë i takon Pejës. Për një vlerësim dhe konstatim të tillë të gjithë janë të vetdijëshëm por asgjë nuk ndërmarrin se këtë ta ndryshojn. Në bazë të ligjit mbi arsimin fillor dhe atë të mesëm në Kosovë, e drejta për arsimin special është e drejtë e pa tjetërsuar.

Peja, edhe në nivelin e arsimit të lartë, si në të gjitha fushat tjera të zhvillimit institucional dhe shoqëror në Kosovë, me Shkollën e Lartë Ekonomike Komerciale në Pejë të themeluar në vitin 1960¹¹⁷, e cila ishte njëra nga tre institucionet e para të

¹¹⁶ Të dhënat statistikore të marrura nga Drejtoria e Arsimit dhe Teknologjisë të komunës së Pejës me date 11.12.2015

¹¹⁷ Monografia e Universitetit të Prishtinës 1970-2005. Prishtinë, 2005. Fq 12 dhe 13. Institucioni i parë i arsimit të lartë në Kosovë ishte Shkolla e Lartë Pedagogjike në Prishtinë (1958). Një vit pas SHLP të Prishtinës, në vitin 1959 u hap Shkolla e Lartë Administrative në Prishtinë. Institucioni i tretë i nivelit të tillë arsimor ishte SHLEK në Pejë.

=====

arsimit të lart tek ne ishte avangardë e zhvillimit të këtij niveli të arsimit..

Në vitin e parë dhe të dytë, studimet në Shkollën e Lartë Ekonomike në Pejë i vijonin 362 studentë (186 të rregullt dhe 176 me korrespondencë. Gjatë tërë periudhës së ekzistimit të SHLEK-ut, nga viti 1960 deri në vitin 2002, në këtë shkollë kanë diplomuar 2868 studentë shqiptarë nga të gjitha trojet shqiptare në ish Jugosllavi (Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi, Preshevë, Bujanocë, Medvegje etj.)

Që nga themelimi i SHLEK-ut intelektualët dhe institucionet pejane nuk kanë rreshtur të angazhohen që këtë shkollë të lart ta avansojnë në fakultet. Në këtë drejtim ndër vite posaçërisht ishin angazhuar prof. Enver Beqiri, punëtori i parë në Librin amë të punësuarve dhe drejtori i parë shqiptarë i kësaj shkolle. Prof. Sali Lika dhe prof. Ali Sylqa profesor, të cilët në periudha të ndryshme kohore ishin edhe drejtor të kësaj shkolle të lart në Pejë...

Shkolla e Lartë Ekonomike Komerciale në vitin 1990, u largua nga objektet e saja dhe procesin mësimor e vazhdoi në shtëpi private kryesisht të profesorëve të kësaj shkolle, në Shkollën e Vogël "Haxhi Zeka, në zyret e Bashkësisë Islame, Kishën katolike, xhamia të ndryshme etj. Drejtor i kësaj shkolle gjatë kësaj periudhe kohore ishte prof. Mehdi Gjakova.

Pas lufte, që nga viti 1999 drejtor i SHLEK-ut ishte prof.dr. Ali Sylqa.

Gjatë gjithë kësaj kohe kjo shkollë e lartë ishte pjesë e Universitetit të Prishtinës ku studentët mund të studionin në dy drejtime: Afarizmi financiar në ndërmarrje dhe Afarizmii ndërmarrjeve hotelirike – turistike.

Më në fund pas më shumë se 40të viteve të angazhimit, në vitin akademik 2001/2002. Shkolla e Lartë Ekonomike u reformua sipas modelit të Deklaratës së Bolonjës dhe po në këtë vit shkollor Senati i Universitetit të Prishtinës miratoi planet mësimore sipas kësaj deklarate për nivelin bachelor. Kjo shkollë u riemërua në Shkolla e Biznesit dhe pastaj në Fakulteti i Shkencave të Aplikuara të Biznesit me këto drejtime: Administrim Biznesi, Informatikë dhe Menaxhmenti në turizëm dhe hotelieri. Shkollimi kishte gjashtë semestra dhe zgjaste tre vite. Ky avansim i nivelit arsimor nga SHLEK në Fakultet biznesi u bë falë angazhimit dhe kontributit të jashtzakonshëm të prof. Edmond Beqirit.

Në Fakultetin e Biznesit nga themelimi e deri te avansimi në Universitet kanë diplomar 1050 studentë

Intelektualët pejan, nuk u "kënaqën dhe nuk u pajtuan vetëm me themelimin e fakultetit por insistonin dhe kërkonin që Peja ta ketë edhe Universitetin e saj publik... Nga kjo dëshirë ka rrjedhë edhe iniciativa institucionale për themelimin e këtij universiteti nga Shoqata e Veteranëve të Arsimit të Pejës, e drejtuar nga prof. Fetah Çavdarbasha – kryetar, prof. Murat Morina, prof. Turhan Gjokolli etj. Këtë iniciativë, me të gjitha forcat e kanë përkrahur dhe ndihmuar ish dekanët e Fakultetit të Biznesit: prof. dr Ali Sylça, prof.dr. Edmond Beqiri, institucionet komunale, pejanët

=====

në institucionet qendrore të Kosovës, ndërsa tërë këtë proces e ka përmbyllur, me angazhim dhe kontribut të jashtëzakonshëm prof. dr. Armand Krasniqi, rektori i parë në detyrë për themelimin e këtij Universiteti publik në Pejë.

Në kuadër të Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë, aktualisht funksionojnë këto fakultete: Fakulteti i Binesit, Fakulteti Juridik, Fakulteti i Menagjimit të Turizmit dhe Hotelierisë, Fakulteti i Agrobiznesit dhe Fakulteti i Arteve.

Në Universitetin “Haxhi Zeka” vijnë në mësimin me mijëra student në dy gjuhë, në atë shqipe dhe boshnjake.

Është një vlerësim i përgjithshëm që niveli i organizimit, funksionimit e sidomos ai i cilësisë në këtë Universitet “ka shumë për të deshiruar”.

Perfundimet

Historia e shkollës dhe arsimit shqip në Pejë, ka ekzistuar dhe zhvilluar që nga kohrat e hershme Ilire, ka vazhduar e mbijetuar edhe në rrethana dhe vështërsi të shumta gjatë okupimeve shekullore, prandaj pa kurfarë ngurimi mund të konstatohet se historia e shkollës shqipe në Pejë, sikurse në të gjitha trojet tjera shqiptare është një histori e luftash, përpjekjesh permanente për mbrojtjen dhe zhvillimin e saj.

Kjo fushë me rëndësi të veçantë shoqërore, sidomos për shoqërinë pejane ka mbetë pothuaj tërësisht e pa hulumtuar, sa që për shkak të mosgadishmërisë dhe mosinteresimit për punë më përmbajtësore hulumtuese e shkencore, institucionet kompetente dhe përgjegjëse komunale e më gjërë, shfrytzojnë të dhëna jo valide e të paqendrueshme historikisht dhe shkenctarisht, të cilat Pejës i shkaktojnë një padrejtësi historike e civilizuese... Këtë konstatim e bazoj edhe në faktin më themelor të kohës më të re, kur institucionet komunale të Pejës, në veçanti ato arsimore në vitin 2015 shënuan 100 vjetorin e themelimit sipas tyre të shkollës së parë shqipe në Pejë, fakt ky që nuk qëndron dhe nuk ka asnjë bazë historike apo shkencore. Këte e argumentojnë edhe dokumentet dhe faktet historike të e pasqyruar edhe në këtë punim.

Okupuesit e Pejës ndër shekuj, në veçanti Perandoria Osmane, Mbretëria, shteti dhe kisha serbe si dhe mbretëria malazeze ishin armiqët më të mdhënjë të shkollave dhe arsimit shqip gjatë shekujve nga ana tjetër Austro Hungaria, Italia e Musolinit apo gjermania e Hitlerit ishin fuqitë e kohës jo vetëm që i lejuan shkollat shqipe por edhe ndihmuan në hapjen, zhvillimin dhe mbarëvajtjen e këtyre shkollave shqipe...

Një nga shqetësimet më të theksuara që rezultojnë nga ky punim është fakti se në një periudhë kohore prej 9 viteve (2004 – 2013), në Komunën e Pejës numri i

=====

nxënësve në nivelin e arsimit fillor (klasa I-IX) është zvogluar për 3.605 nxënës ose 133 paralele, ndërsa në ato të mesme (klasa X-XII) vetëm gjatë dy viteve shkollore 2012-2013 ku kanë qenë të regjistruar 6.372 nxënës, ky numër në vitin 2015-2016, ka zbritur në 5.203 nxënës apo 1.169 nxënës më pak...!!! Të dhënat e pasqyruara në këtë punim, obligojnë institucionet relevante, në veçanti studiuesit e rinjë që të hulumtojnë historikun e arsimit shqip ndër shekuj në Pejë, se kjo fushë me rëndësi të veçantë shoqërore, shtetërore e kombëtare pothuaj ka mbetë tërësisht e pandrikuar, edhe me këtë punim të prezentuar nga unë dhe nga ana tjetër institucionet relevante, kompetente e përgjegjëse dhe vet shoqërinë pejane të mirren më seriozisht dhe në mënyrë më cilësore e profesionale me problemin e arsimit në Komunën e Pejës nga të gjitha pikëpamjet e saja, se gjendja në këtë fushë shoqërore dhe shtetërore është më shumë se shqetsuese e alarmuese.

Burimet dhe literatura:

- Dr. Branko Petranoviq "Istoria Jugoslavije 1918-1978"
- Prof.Dr. Cahid Baltaci.XV, XVI.Asirlada Osmanli Medreseleri,Istanbul,1976,
- Drejtoria e Arsimit dhe Teknologjisë të Komunës së Pejës
- Prof.Dr. Edmond Beqiri, Monografi - 50 vite traditë, kulturë, arsimim – FSHAB, Universiteti i Prishtinës, 2010
- Dr.dom Gaspër Gjini. Peshkopata e Shkupit dhe e Prizrenit gjatë shekujve. Zagreb,1986
- Gazeta "Slobodna misao" nr.1 të vitit 1934.
- Gazeta "Zetski glasnik", nr. 35 i vitit 1934
- Gazeta" Zetski glasnik" nr.101 i vitit 1934.
- Qeveria e Kosovës- Ministria e Shërbimeve Publike. Seria-5 statistikat Sociale. Statistikat e Arsimit në Kosovë 2003 – 2004.Tabela 9, 36,70
- Prof.Dr. Nesim Vala. Kjo është Gjakova. Gjakovë 2015.
- Monografia e Universitetit të Prishtinës 1970-2005. Prishtinë
- Pavle Joviqeviq dhe Mita milkoviq "Lufta e komunistëve të Pejës midis dy luftërave (1918-1941). Botuës: Këshilli Komunal i, LSHL, LNÇ Pejë
- Reshat Nurboja. Peja nëpër vite e shekuj. Pejë,2016
- Prof.Dr. Skender Rizaj. "Kosova gjatë shekujve XV,XVI dhe XVII. Rilindja Prishtinë 1982,